



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

8 mars – 25 shtator 2011

**RAPORT I DORËZUAR NË BASHKIMIN EVROPIAN/ SHËRBIMIN EVROPIAN PËR
VEPRIM TË JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 27 shtator 2011

Parathënie

Në këtë raport mund të gjeni përditësimet mbi zbatimin e pesë marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Me përjashtim të Marrëveshjes për vulat doganore, e cila është zbatuar vetëm nga Qeveria e Kosovës që prej datës 16 shtator 2011, procesi i zbatimit në përgjithësi është duke u vonuar.

Qeveria e Kosovës konsideron se zbatimi efektiv dhe efikas i marrëveshjeve paraqet çelësin e suksesit të dialogut. Prandaj, ne do të dëshironim që me dashamirësi të kërkojmë nga ju që të ndërmerrni çdo masë të mundshme për zbatimin, posaçërisht përcaktimin e afateve kohore që të dyja palët do t'i nënshtroheshin përmbushjes së detyrueshme.

Sinqerisht,



Edita Tahiri

Zëvendëskryeministre

Kryenegociatore dhe Udhëheqëse e Delegacionit
të Republikës së Kosovës në Dialogun teknik të
Brukselit

Përmbajtja:

1. Përditësimet në zbatimin e marrëveshjes për vulat doganore
2. Përditësimet në zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes
3. Përditësimet në zbatimin e marrëveshjes për regjistrat civil
4. Përditësimet në zbatimin e marrëveshjes së pranimin të diplomave universitare
5. Përditësimet në zbatimin e marrëveshjes për dokumentet kadastr

1.
PËRDITËSIMET NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR VULAT
DOGANORE

27 shtator 2011

Që nga marrëveshja e datës 2 shtator 2011 e cila rezultoi me pranimin reciprok të vulave doganore në mes të Kosovës dhe Serbisë, ne kemi bërë çdo përpjekje të mundshme për ta siguruar lëvizjen e lirë të mallrave në përputhje me rregullat e CEFTA-s. Kosova dhe Serbia ranë dakord që vula doganore që mban mbishkrimin "Dogana e Kosovës", e pranuar dhe konfirmuar nga të gjitha vendet antare të CEFTA-së, të pranohet edhe nga Serbia, dhe kjo vulë do të përdoret në të gjitha dokumentet shoqëruese dhe komunikuese. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, tregtia normale do të duhej të rifillonte menjëherë në pajtim me Marrëveshjen e CEFTA-s. Nga ana jonë, kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 16 shtator 2011 dhe Qeveria e Kosovës ka bërë çdo përpjekje të mundshme për t'i krijuar të gjitha kushtet e duhura operative për zbatimin e Marrëveshjes në këtë datë. Deri më 19 shtator 2011, në Kosovë kanë hyrë 182 kamionë me mallra me origjinë nga Serbia.

Katër ditë pas fillimit të zbatimit të marrëveshjes së datës 2 shtator 2011, për fat të keq, Serbia nuk shprehu gatishmërinë për zbatimin e marrëveshjes. Të gjithë kamionët me mallra me origjinë nga Kosova janë kthyer prapa në kufi. Arsyetimi i Doganës së Serbisë ishte se ata nuk kishin udhëzime nga autoritetet serbe për pranimin e vulave doganore të Kosovës. Më 19 shtator 2011, tre kamionë nga Kosova janë lejuar të hyjnë në Serbi për pak kohë. Ata u dërguan deri në terminalin doganor në Preshevë, Serbi, dhe të njëjtët kamionë u kthyen në Kosovë ditën tjetër, më 20 shtator 2011.

Që nga atëherë, autoritetet serbe kanë paraqitur kërkesë të re (e që ka hyrë në fuqi më 16.09.2011) sipas të cilës të gjitha dërgesat nga Kosova duhet ta kenë faturë serbe për pagesën e TVSH-së e cila mund të paguhet vetëm në zyrat paralele serbe në Ranillug ose në veri të Mitrovicës. Nuk ka arsye që Serbia të kërkojë më shumë dokumente për mallrat me origjinë nga Kosova, dokumente që nuk kërkohen nga palët e tjera të CEFTA-s.

Kamionët nga Kosova që presin të hyjnë në Serbi nuk kishin dokumente të tjera përveç faturave tregtare dhe deklarata të eksportit të vulosura nga Dogana e Kosovës, si konfirmim për largimin nga Kosova. Në parim, sipas marrëveshjes së CEFTA-s, nëse vlera e mallrave

të eksportuara është më e ulët se 5000 euro, kompania nuk ka nevojë ta paraqesë dokumentin EUR1 dhe deklaratën e eksportit. Nga ky rregull përjashtohen rastet e ushqimit dhe mallrave tjera që duhet të paraqiten me dokumentet fitosanitare dhe veterinare.

Edhe pse këto zhvillime janë në kundërshtim me zbatimin e konkluzioneve të marrëveshjes së 2 shtatorit 2011, në frymën e dialogut dhe për hir të lëvizjes së lirë të mallrave jemi treguar konstruktivë. Ekonomikisht, Kosova është shumë më e rëndësishme për Serbinë se sa Serbia që është për Kosovën. Sidoqoftë, jemi përmbajtur që mos t'i rikthejmë masat e reciprocitetit (siç kemi bërë më 20 korrik 2011). Derisa besojmë që Serbia do ta ndryshojë qëndrimin e saj në favor të zbatimit të plotë të marrëveshjes së 2 shtatorit 2011, duhet nënvizuar se kjo situatë nuk do të jetë e pranueshme për ne. Presim që në raundin e ardhshëm të bisedimeve gjatë 27-28 shtatorit 2011, do të vendoset afati kohor për zbatimin e plotë dhe të kompletuar të marrëveshjes nga ana e Serbisë, përndryshe nuk ka kuptim tregtia e lirë e njëanshme që të ndiqet nga Kosova, duke pasur parasysh pasojat negative të saj për ekonomin tonë dhe presionin në rritje nga sektori afarist.

Ndërmjet 16 dhe 27 shtatorit 2011, në Kosovë kanë hyrë 1400 kamionë nga Serbia; në pikën kufitare në Merdare kanë hyrë 1020 kamionë me mallra me origjinë nga Serbia, në pikën kufitare Dheu i Bardhë 380 kamionë kanë hyrë në Kosovë. Dje, më 23 shtator 2011, kemi marrë lajmin nga Dogana e Kosovës se 4 kamionë nga Kosova, me dokumente të rregullta të Kosovës, janë lejuar të hyjnë në Serbi. Derisa është përpiluar ky raport nuk kemi marrë ndonjë informatë që konfirmon ndryshe.

Në një shënim të ndërlidhur me këtë çështje, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës na ka informuar se agjencia përkatëse serbe e ushqimit dhe veterinarisë nuk lejojnë kalimin transit të kafshëve të gjalla që vijnë nga vendet e BE-së përmes Serbisë. Madje, pala serbe nuk lëshon certifikatë shëndetësore për kafshët e gjalla kur eksportohen nga Serbia. Certifikata shëndetësore lëshohet nga të gjitha vendet tjera. Ata nuk lëshojnë as certifikata fitosanitare për produktet me fito-bazë.

Megjithatë, po e përcjellin situatën nga afër dhe do t'iu njoftojmë për zhvillimet e reja. Ndërkohë, po i bashkëngjisim disa letra dhe dokumente të cilat mund të jenë të dobishme. Për çdo informatë dhe sqarim të mëtejshëm iu lutem më kontaktoni përsëri.

2.
PËRDITËSIMET NË ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR LIRINË E
LËVIZJES

27 shtator 2011

Zhvillimet:

Marrëveshja kornizë për lirinë e lëvizjes u arrit më 2 korrik 2011. Korniza kërkon dhe u vendos gjithashtu që të krijohen grupe punuese ekspertësh për t'i përgatitur të gjitha kushtet e nevojshme formale për funksionalizimin e marrëveshjes.

Deri më tani, janë mbajtur tre takime mes grupeve punuese të ekspertëve kryesuar nga një lehtësues i caktuar nga BE-ja. Takimet u mbajtën më 11 korrik 2011, 19 korrik 2011 dhe 5 shtator të vitit 2011.

Grupet e punës kanë diskutuar për këto çështje:

1. Metodologjitë për kalimin kufitar
 - Letërnjoftimet dhe patentë shoferi;
 - Dokument hyrës dalës;
 - Kalimi kufitar për fëmijë/ të rinj;
 - Pikat e kalimit kufitar për kalim transit për në vendin e tretë.
2. Sigurimi kufitar
3. Regjistrimi i automjeteve

Deri sa është mbajtur takimi mes të deleguarve të grupit punues të ekspertëve të Kosovës dhe kryesuesit/ lehtësuesit të BE-së të grupit punues të ekspertëve për lirinë e lëvizjes të mbajtur më 13 shtator 2011, çështjet që janë përfunduar dhe çështjet që kanë mbetur të pazgjidhura janë:

Çështjet e përfunduara:

1. Sipas metodologjive për kalimit kufitar, është rënë dakord që:

- Fëmijët nga mosha 0-12 vjeç nga të dyja vendet mund ta kalojnë kufirin duke përdorur dokumente si certifikata e lindjes, dokument nga institutet sociale, dokument i gjykatës, etj. pa pasur nevojë për dokumentin për hyrje dalje. Ndërsa fëmijët nga 12-18 vjeç mund ta kalojnë kufirin me dokumentet e lartpërmendura, por duhet tu lëshohet dokumenti për hyrje dalje;
- Pasi nga të dyja palët janë shkëmbyer dokumentacionet e nevojshëm për ekzaminimin nga ekspertët të specifikimeve të letërnjoftimeve dhe patentë shoferëve, është arritur pajtim që çdo qytetar i Kosovës duhet ta ketë lejen e re të vozitjes.
- Është konstatuar se me qëllim të identifikimit të personave që udhëtojnë ose kalojnë transit nëpër Serbi, letërnjoftimi dhe dokumenti për hyrje dalje të tregohen së bashku;
- Është arritur pajtim që dokumenti i lëshuar nga autoritetet serbe në kufi zyrtarisht të quhet Dokument për hyrje dalje. Pala serbe kërkon të gjejë tjetër karakteristikë të sigurisë nga letërnjoftimi përveç fotos në mënyrë që të finalizohet dokumenti;
- Janë pajtuar për pikat kufitare për kalim si dhe për kalim transit në një vend të tretë. Fillimisht, duke u bazuar në kërkesën e palës serbe, u ra dakord që pesë pikat e kalimit të iniciohen në fillim të regjimit. Pikat kufitare 1, 3 dhe 5 në kufirin Kosovë-Serbi dhe në pikën kufitare të Horgoshit në kufirin me Hungarinë dhe në Batrovç në kufi me Kroacinë duhet të hapen për ta filluar regjimin e lirisë së lëvizjes.

2. Sa i përket sigurimit kufitar jemi pajtuar që:

- Palët ranë dakord që t'i përdorin burimet e Byrosë së Sigurimeve të një vendi të tretë me qëllim që të veprojnë si garanci në regjimin e sigurimit kufitar;
- Të dyja palët ranë dakord që ta krijojnë një fond nën menaxhimin e palës së tretë si fond garantues;
- Palët, pas miratimit nga tre kryesuesit, u pajtuan që të takohen dhe të diskutojnë për çfarëdo çështje të pazgjidhur në mënyrë që regjimi i sigurimit kufitar të jetë i gatshëm për tërë regjimin e lirisë së lëvizjes.

3. Targat e automjeteve

- Përdorimi aktual i targave të përkohshme të automjeteve që përdoren në Serbi, me simbolet shtetërore, do të jetë sistemi fillestar në përdorim, me kusht që në kohën e duhur Serbia ta ndryshojë legjislacionin e nevojshëm dhe aspekte tjera të nevojshme për ta lehtësuar një sistem pa simbole shtetërore.
- Kosova do ta merr çdo masë reciprociteti të ndërmarrë nga Serbia në lidhje me targat e përkohshëm.

Çështjet e pazgjidhura:

1. Metodologjitë për kalimin kufitar

- Për sa i përket letërnjoftimeve dhe patentë shoferit, pas shumë pyetjeve të bëra në lidhje me këtë çështje, pala serbe do të ekzaminon aspektet e nevojshme teknike për procedimin e letërnjoftimeve dhe patentë shoferëve. Palës serbe është dashur të jep një afat kohor të nevojshëm për t'i siguruar artikujt e nevojshëm teknik siç është skaneri¹, por deri më tani nuk e ka bërë. Në esencë, grupi i ekspertëve të punës për zbatimin e lirisë së lëvizjes nuk ka qenë i informuar se sa kohë u duhet palës Serbe sipas ligjeve për ta zbatuar këtë procedurë.
- Specifikimet e dokumentit për hyrje dalje siç është çështja e fotografisë e cila është kundërshtuar nga pala e jonë dhe shënimet shpjeguese në pjesën e prapme të dokumentit ende nuk janë finalizuar;

2. Sigurimi kufitar

- Shumë çështje mbeten të pazgjidhura në lidhje me sigurimin kufitar. Kjo është për shkak se pala serbe shmang takimet me palën kosovare për ta diskutuar opsionet edhe pas insistimit të palës kosovare për tu takuar dhe diskutuar çështjet e pazgjidhura siç është rënë dakord në takimin e 4 shtatorit 2011.²

¹ Datat për kohëzgjatjen e prokurimit u premtuan në takimin e dytë të mbajtur më 11 korrik 2011. Megjithatë, edhe në takimin e fundit ata nuk ishin në gjendje të thonë se kur mund të sigurojnë teknologjinë e nevojshme për leximin e letërnjoftimeve. Ata vazhduan të kërkonin gjithnjë e më shumë informata që iu prezantuan në takimin e dytë.

² Shihni korrespondencën me e-mail mes kryetarit të Byrosë së Siguruesve të Kosovës z. Rrahim Pacolli dhe Z. Vladan Manic, Sekretarit të përgjithshëm të Shoqatës së siguruesve serbë.

Komentet dhe rekomandimet

Siç e kam kuptuar, disa elemente mund të sjellin zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes deri në atë pikë ku mund ose mos ta arrijë afatin e 1 nëntorit 2011 ose të prishet plotësisht. Këto elemente janë:

- Letërnjoftimet dhe patentë shoferët, koha e nevojshme për zbatimin e çështjeve të nevojshme teknike mund të jetë më e gjatë se afati i 1 nëntorit i përshkruar në marrëveshjen kornizë.
- Dokumenti e hyrje daljes ka qenë pika më e vështirë për diskutim. Dy pika kanë qenë pengesë kryesore për diskutime:
 - a) Insistimi i serbëve që të jetë dokumenti për hyrje dalje (DHD) si dokument i vetëm identifikimi në territorin e Serbisë, duke e prodhuar atë me fotografi, dhe;
 - b) Përfshirë dhe shënimin shpjegues se ky do të jetë dokumenti i identifikimit në territorin e Serbisë.
- Pala kosovare ka insistuar që mos të përfshihet fotoja dhe shënimi shpjegues përgjegjesisë në DHD, përndryshe çështja do të shtrohet në takimet plenare të dialogut. Kështu që ose nevojitet vendim politik nga pala serbe ose një propozim i ndërmjetësuar nga ndërmjetësi i BE-së
- Sigurimi kufitar nuk mund të jetë aq problematik në arritjen e marrëveshjeve të kërkuara, por për shkak të shmangies së takimeve nga pala serbe, mund të ketë ndikim negativ në regjimin e lirisë së lëvizjes, veçanërisht në përmbushjen e afatit të 1 nëntorit.

3.

PËRDITËSIMI MBI MARRËVESHJEN E REGJISTRAVE CIVIL

27 Shtator 2011

Zhvillimet:

Çështja e kthimit të librave të regjistrave civil është diskutuar në raundin e parë (8 dhe 9 mars 2011) në Bruksel. Si vazhdimësi e takimit, më 28 mars, në Bruksel u diskutua *finalizimi i zbatimit të marrëveshjes së regjistrave civil* pas themelimit të një Grupi Punues të përbashkët mbi zbatimin, të udhëhequr nga EULEX-i me qëllim të lehtësimit të kësaj marrëveshjeje. Kryesuesi i grupit punues të zbatimit u emërua Zëvendës shefi i EULEX-it, z. Andy Sparks.

Deri më tani janë mbajtur pesë takime në nivel teknik:

1. Takimi i parë i grupit punues të udhëhequr nga EULEX-i, e mbajtur më 5 prill 2011 -Bruksel
2. Takimi i dytë i grupit punues të udhëhequr nga EULEX-i, e mbajtur më 15 prill 2011 -Bruksel
3. Vizita e delegacionit të Kosovës dhe EULEX-it në Nish, Serbi, në lidhje me një pilot projekt mbi regjistrat civil (09.06.2011)
4. Vizita e delegacionit të Serbisë në Prishtinë dhe Lipjan, Kosovë, në lidhje me një pilot projekt mbi regjistrat civil (23.06.2011)
5. Takimi i grupit punues të udhëhequr nga EULEX-i, 19.07.2011 në Bruksel

Gjendja e përgjithshme:

Delegacioni i Kosovës ka bërë një vizitë në Nish, më 09 qershor 2011, në përputhje me disa nga pikat e dakorduara nga delegacionet e ekspertëve nga Kosova dhe Serbia në takimin e mbajtur në Bruksel më 15 prill 2011. **Gjatë kësaj vizite, palët shkëmbyen statistikave të regjistrave civil të komunës së Lipjanit** dhe u dakorduan që të përgatisin një dokument "Regjistri i dorëzimit të statistikave mbi Statusin e Gjendjes Civile për komunën e Lipjanit". Dokumenti duhej të nënshkruhej nga të gjitha palët gjatë vizitës kthyesë të delegacionit të Serbisë në Lipjan.

Delegacioni i Serbisë vizitoi Lipjanin, më 23 qershor 2011, **por ata asnjëherë nuk sollën asnjë dokument ashtu siç u dakorduan në Nish, e as nuk e kanë nënshkruar**

dokumentin “Regjistri i dorëzimit të statistikave mbi Statusin e Gjendjes Civile për komunën e Lipjanit”, të paraqitur nga delegacioni i Kosovës.

Delegacioni i Kosovës reagoi ndaj dështimit të palës serbe duke rikujtuar detyrimet e marra në takimin në Nish duke deklaruar se dështimi për t'i përmbushur ato përbën shkelje të marrëveshjes. Kjo u konfirmua edhe nga ndërmjetësi i BE-së, i cili deklaroi se do ta shqyrtojë rastin.

Më 19.07.2011, në Bruksel u mbajt një takim pasues ndërmjet grupeve operative mbi implementimin e marrëveshjes mbi regjistrimin civil.

Diskutimet për strukturat paralele dhe regjistrimet paralele/të dyfishta duhet të zgjidhen nga formati politik i të dyja palëve. Nga pikëpamja e BE-së regjistrimi paralel/i dyfishtë konsiderohet një problem dhe i hap rrugën krimit të organizuar dhe vjedhjes së identitetit.

Është theksuar se parlamenti i Serbisë do të vendosë për miratimin e **ndryshimeve/plotësimeve të propozuara në Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale** për të filluar procedurën për vërtetimin e kopjeve origjinale të librave të RC nga EULEX-i.

Opsionet e propozuara për procesin e vërtetimit të kopjeve:

- A) Procesi i vërtetimit të kopjeve do të bëhet sipas modelit ekzistues të skanimit në Kosovë të librave të RC në Prishtinë.
- B) Riprodhimi (replikimi) i modelit ekzistues të skanimit në Kosovë, por të bërë në Serbi. Ky sistem i riprodhimit duhet të jetë në përputhje të plotë me modelin ekzistues në Kosovë.
- C) Kopja fizike e librave të RC, faqe për faqe, e pasuar nga vërtetimi i kopjeve.

Duke pas parasysh faktin se sipas legjislacionit serb, librat fetar do t'i kthehen pronarëve deri në janar 2012 (komunitetet fetare siç janë: ai Islam, i Krishterë, Hebraik...), të gjitha palët kanë propozuar që procedura e kopjeve të vërtetuara duhet **së pari të nisë me librat fetar.**

Gjendja e përgjithshme dhe çështjet e pazgjidhura:

1. Palët kanë shkëmbyer statistikat (kopje fizike) mbi regjistrat e gjendjes civile për komunën e Lipjanit, në Nish, më 09 qershor 2011.
2. Delegacioni i Kosovës ka përgatitur “Regjistrin e dorëzimit të statistikave mbi Statusin e Gjendjes Civile për komunën e Lipjanit”, kurse delegacioni i Serbisë nuk e ka përgatitur dokumentin e tyre të dorëzimit për tabelat tashmë të shkëmbyera të inventarit siç ishin dakorduar në Nish, gjatë vizitës së parë. Pala serbe ka deklaruar gojarisht se në Nish gjenden gjithsej 1293 regjistra të gjendjes civile të lindjes, martesës dhe vdekjes, të gjitha origjinalet nga komuna e Lipjanit dhe se ata nuk kanë as bazë të të dhënave elektronike, e as arkiv elektronik të të dhënave.
3. Dokumenti, “Regjistri i dorëzimit të statistikave mbi Statusin e Gjendjes Civile për komunën e Lipjanit” i përgatitur nga delegacioni i Kosovës, nuk është nënshkruar nga delegacioni i Serbisë, në Lipjan, më 23/06/2011, me arsyetimin se udhëheqësi i tyre, Dejan Pavliqevic, i cili është i autorizuar për këto statistika, nuk ishte prezent.
4. Pala serbe duhej të vendoste për një nga tre opsionet e skanimit, 7 ditë pas takimit të 19 korrikut 2011, megjithatë deri më tani nuk ka asnjë përgjigje.
5. Pala kosovare i ka të gatshme specifikimet teknike dhe teknologjike të pajisjeve të saja të skanimit, por asnjë kërkesë nuk ka arritur nga ana e Serbisë.
6. Asnjë përditësim nuk është pranuar nga Z. Andy Sparks për gjendjen e përgjithshme të kësaj çështjeje.

PËRDITËSIMI MBI PRANIMIN E DIPLOMAVE UNIVERSITARE
27 Shtator 2011

Zhvillimet:

Më 2 korrik 2011, u arritën konkluzionet e dakorduara mbi diplomat universitare, që kërkon 'certifikimin' e diplomave universitare ta bëjë një palë të tretë ndërmjetësuese. Konkluzionet e dakorduar nuk ka përcaktuar se kush do të jetë pala e tretë, por në mbledhjen e mbajtur më 2 shtator 2011 dhe rrjedhimisht në dokumentin me zgjidhjen e propozuar nga BE-ja për pranimin e ndërsjellë të diplomave universitare kjo detyrë do të kryhet nga Asociacioni Universiteteve Evropiane (AUE). Në mes tjerash, dokumenti e përcakton metodologjinë e vërtetimit të diplomave universitare.

Në parim, Kosova është pajtuar me zgjidhjen e propozuar për këtë çështje nga BE-ja. Çështja iu komunikua palës propozuese, më 15 shtator 2011 dhe mbetet në anën e Serbisë që t'i përgjigjet propozimit. Deri më tani, nuk na është komunikuar asnjë informatë kthyese për propozimin.

Rekomandimet:

Siç e kemi theksuar në përgjigjen ndaj propozimit të BE-së, qëllimi i marrëveshjes është të lehtësojë problemet me të cilat ballafaqohen studentët, si në mundësitë për punësim, ose në avancimin e studimeve të tyre. Kështu, me zotimet nga ana e BE-së dhe Serbisë se procesi i pranimit të diplomave do të jetë një kapitull i mbyllur dhe nga tani e tutje, në të dy shtetet studentët do të jenë në gjendje të gjejnë punësim ose të vazhdojnë studimet në të dyja vendet, do ta forcojë zotimin nga të dyja palët dhe po ashtu rolin e AUE-së. Në të ardhmen nuk duhet të vendosen barrierat të tjera në njohjen reciproke të diplomave për studentët e diplomuar në universitetet në Kosovë, ne do të veprojmë në mënyrë reciproke

5.
**PËRDITËSIMI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES SË DOKUMENTEVE
KADASTRAL
27 Shtator 2011**

Zhvillimet:

Në takimin ndërmjet ekspertëve të BE-së dhe ekipit tonë më 13 shtator 2011, është diskutuar procesi i zbatimit të marrëveshjes mbi dokumentet kadastral.³

Përfaqësuesit e BE-së kanë ngritur çështjet e mëposhtme:

1. Kanë kërkuar gatishmërinë tonë për fillimin e zbatimit të marrëveshjes kadastrale.
2. Fillimi i ndryshimit të ligjit për AKP-në sepse marrëveshja parashikon një rol të zgjeruar të AKP-së, e cila heton ankesat dhe së bashku me një mekanizëm të tretë të BE-së i referon ankesat e mekanizmit gjyqësor (Mechanism adjudication).
3. Ndryshimi i emrit të Agjencisë Kosovare të Pronës ose të bëhet një emër që reflekton zotime shtesë për kontestet kadastrale.
4. Përgjegjësinë për zgjedhjen e shefit të ri të AKP-së do ta ketë PSBE-ja dhe jo Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar siç është e shënuar në ligjin e aktual.

Përgjigja e Kosovës:

1. Gatishmëria për fillimin e zbatimit të marrëveshjes kadastrale.
2. Ne do të fillojmë procesin e ndryshimit të ligjit për Agjencinë Kosovare të Pronës. Tashmë kemi kontaktuar Zyrën Ligjore pranë zyrës së Kryeministrit për procesin e ndryshimeve të ligjit përmes Zyrës Ligjore pranë zyrës së Kryeministrit. Kur palët të jenë të gatshme të fillojnë këtë proces, ata do ta vazhdojnë procesin e përgatitjes së terrenit për këtë proces në bashkëpunim me të gjithë akterët të cilët do të jenë të përfshirë, për shembull: Kuvendi i Kosovës, Qeveria, PSBE-ja, ICO-ja, Komisioni Evropian, etj.
3. Kosova do të ofrojë propozim konkret për ndryshimin e emrit të Agjencisë së AKP-së, por kjo do të bëhet edhe përmes ndryshimeve të ligjit për AKP.
4. Kosova do ta themelojë grupin e zbatimit.

³ Në mbledhje morën pjesë: Dren Zeka, Qemajl Marrmullakaj, Thomas Busch dhe Andrej Kiendl

Hapat e zbatimit të marra nga Kosova:

1. Grupi i zbatimit i Kosovës është themeluar. Përbëhet nga: Gazmir Raci nga Zyra e Zv. Kryeministres Tahiri, Murat Meha nga AKK-ja, Scot Bowen dhe Xhevat Ademi nga AKP-ja.
2. Takimet fillestare për fillimin e përgatitjes janë mbajtur. Më 14 shtator 2011, u mbajt takimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe më 16 shtator 2011, takimi me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP).
3. AKP-ja e konfirmoi gatishmërinë e pjesëmarrjes aktive në këtë proces, sa herë që të jetë e nevojshme.
4. Zyra ligjore e Kryeministrit është duke punuar në procedurat e ndryshimit të ligjit që do të reflektojnë në zgjerimin e mandatit të AKP-së dhe emrit për integrim në mekanizmat gjykues, siç kërkohet nga Marrëveshja e Regjistrave Kadastral.
5. Presim që të marrim të informacione nga BE-ja, në lidhje me agjencinë teknike dhe themelimin e një grupi trepalësh për zbatim.

Shtojca 1:

Ekspertët dhe Koordinatorët nga Kosova

I. Vulat doganore

Koordinator: Dren Zeka:

1. Naim Huruglica – Drejtor i Doganave të Kosovës
2. Florent Bakija – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

II. Liria e lëvizjes

Koordinator: Lirim Greiçevci

1. Fisnik Rexhepi – Këshilltar i Ministrit të Punëve të Brendshme
2. Shaban Guda – Drejtor i Njësisë së Policisë Kufitare
3. Flamur Mrasori – Banka Qendrore e Kosovës
4. Rrahim Pacolli – Shefi i Rrjetit të Sigurimeve të Kosovës
5. Qemajl Marmullakaj – ZPS – Zyra e Kryeministrit (MPB)
6. Sebahate Muharremi Pllana – Drejtoreshë e Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve dhe Patentë Shoferëve (MPB)

III. Librat e Regjistrave Civil

Koordinatore: Arjeta Rexhaj

1. Blerim Camaj - Kryeshef ekzekutiv – Agjencia e Regjistrimit Civil (MPB)
2. Shkumbin Kastrati – Drejtor i Departamentit të Regjistrimit Civil (MPB)
3. Shefket Ismaili – Udhëheqës i Njësisë së Regjistrave Civil (MPB)

IV. Pranimi i Diplomave

Koordinator: Qemajl Marmullakaj

1. Gjylbehare Llapi – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

V. Regjistrat Kadastral

Koordinator: Gazmir Raci

1. Murat Meha – Kryeshef Ekzekutiv, Agjencia Kadastrale e Kosovës
2. Scott Bowen – Drejtor, Agjencia Kosovare e Pronës
3. Xhevat Ademi – Zëvendës Drejtor, Agjencia Kosovare e Pronës